



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

VENDIM

Nr. 69, datë 28.10.2020

“PËR
NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZONJËS SOFIA ZHILLA NË VENDIN VAKANT
PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I
DREJTËSISË NË DATËN 07.02.2020”

KOMITETI I EMËRIMIT EDHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE i përbërë nga :

Artur Metani - Kryetar
Mirela Kapo - Anëtare
Marsela Pepi- Anëtare

Asistuar nga sekretare Adela Skora,

në mbledhjen e datës 28.10.2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

INSPEKTOR JO MAGJISTRAT

Zonja Sofia ZHILLA

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të zonjës
Sofia ZHILLA, në vendin vakant për
Inspektor jo magjistrat, të shpallur nga
Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën
07.02.2020.

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 07.02.2020, ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor jo magjistratë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është edhe zonja Sofia ZHILLA.

4. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të gërmës A, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e zhvilluar në datën 07.02.2020, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të pikës 27, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për

pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas administrimit të të gjithë dokumentacioni, në mbledhjen e zhvilluar në datën 26.10.2020, është realizuar dhe rradha e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati.

6. Zonja Sofia ZHILLA, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me kërkesën me nr.prot 177, në datën 19.02.2020 ka shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rrjedhimisht, nisur dhe nga detyrimet ligjore, kandidati, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

7. Në datën 28.04.2020, kandidati Sofia ZHILLA, është paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 07.05.2020, kandidati Sofia ZHILLA ka depozituar në sekretarinë e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

9. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe **kontrollin e pasurisë**, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën përcjellëse me nr. Prot.630 datë 04.05.2020, i ka dërguar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë (I.L.D.K.P.K.I), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve,

që i nënshtrohen procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre .

10. Me shkresën nr. 630 datë 04.05.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunëve publik”, ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së Drejtësisë” .

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Sofia ZHILLA, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatis për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.140/26 prot, datë 21.07.2020, I.L.D.K.P.K.I ka informuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë se kandidati Sofia ZHILLA, e ka përmbushur detyrimin për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatis për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. I.L.D.K.P.K.I, në zbatim të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën nr. 140/26 prot, datë 21.07.2020, ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë në Drejtësi, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Sofia ZHILLA dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën me nr. Prot.1942/2 datë 26.05.2020 nga ana e I.L.D.K.P.K.I njoftohemi se ky institucion kryen verifikime. Konkretisht administron, analizon si dhe kryen veprime verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatis Sofia ZHILLA dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatis Sofia ZHILLA, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i është drejtuar me kërkesa për informacion I.L.D.K.P.K.I-së lidhur me institucionet financiare me të cilat ky institucion ka korrespondencë dhe administron përgjigjet e tyre . Evidentohet se ky institucion kërkon informacion në funksion të kontrollit të plotë:

a) Institucioneve bankare: Banka e Shqipërisë, Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Intesa Sanpaolo, Banka Alpha Albania, Banka Tirana, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Credins, Banka Union, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, RFZ Invest sh.a, Credins Invest sh.a, ASHK, DPSH TRR, Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT, ISSH, D.P Detare.

16. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, **lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit**, në zbatim të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe pikës 59, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. Prot.718 datë 19.05.2020, ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Sofia ZHILLA sipas ligjit nr. 138/2015.

17. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 768/103 prot., datë 15.09.2020, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Sofia ZHILLA.

18. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatis Sofia ZHILLA, kjo zyrë i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 713 prot, datë 19.05.2020*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 712 prot, datë 19.05.2020*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 717 prot, datë 19.05.2020*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 715 prot, datë 19.05.2020*).

19. Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë si institucion i njohur nga ligji lidhur me verifikimin e integritetit të kandidatëve.

20. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me *shkresat nr.7135 prot., datë 27.07.2020 dhe nr. 2401 prot., datë 25.08.2020*.

21. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe **kontrollin e integritetit**, në zbatim të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe pikës 62, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit” i është kërkuar Autoritetit për informim mbi dokumentet e ish sigurimit të shtetit nëse secili kandidat, sikurse tregohen në listën bashkëlidhur përfshihet në

rastin e posaçëm të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar: *“e) ka qenë ose jo anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991”* apo në njërin nga rastet më të përgjithshme të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

22. Me shkresën nr. 719 prot, datë 19.05.2020, zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën nr. 489/1 prot, datë 22.06.2020, ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili është bashkëngjitur praktikës së kandidatit.

24. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerësoi ti drejtohet me kërkesa për informacion **Dhomës Kombëtare të Avokatisë**. Kërkesa është bërë në mbështetje të nenit 209, pika 6, gërma ”ç”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe seksionit B, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, duke kërkuar nëse kandidati, në mënyrë aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjigjur me shkresën nr. Prot.154 datë 02.06.2020 (informacion i cili është administruar në dosjen e kandidatit).

25. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209, pika “e”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me shkresën me nr. Prot. 716 datë 19.05.2020 ka kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve. Konkretisht është administruar informacion nga ana e Prokurorisë së Posacme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar lidhur me :

- Çdo të dhënë apo indicie të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

-Kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e identifikimit të subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale), ku përfshihen edhe biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike.

Me shkresën me nr. Prot. 3648/1 datë 04.06.2020, kjo Prokurori ka dërguar informacionin e administruar në dosjen e kandidatit.

26. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të

drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 27 e vijues, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm .

27. Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 26.10.2020, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të zonjës Sofia Zhilla, për vendin vakant për Inspektor jo magjistrat në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komisionit

28. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Sofia ZHILLA për vendin vakant për Inspektor jo magjistrat pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

29. Në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ,i ndryshuar, konkretisht në nenin 209, në pikën 6, përcaktohen “Kushtet për inspektor jo magjistrat”, prej nga rezulton se:

6. Kandidatët për inspektorë, të cilët nuk janë magjistratë, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;
- b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;
- c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;
- ç) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;
- d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

- dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- e) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;
- ë) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
- f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

30. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar nga ana I.L.D.K.P.K.I-së, në zbatim të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, me shkresën nr. 140/26 prot., datë 21.07.2020, ka dërguar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë në Drejtësi, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Sofia ZHILLA dhe personat e lidhur me të.

31. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Sofia ZHILLA, I.L.D.K.P.K.I në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;**
- b) **ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar të ardhurat e fëmijëve;**
- c) **ka mos deklarim të pasurisë;**
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

32. Lidhur me gjetjet e konstatuara nga ana e I.L.D.K.P.K.I-së kandidati është ballafaquar nëpërmjet emaili-t të datës 24.09.2020 duke i lënë si afat pesë ditë kohë për të paraqitur shpjegimet dhe dokumentacion justifikues. Konkretisht është njoftuar kandidati, mbi të drejtën e tij për të paraqitur, me shkrim, brenda afatit 5 ditor, drejtpërdrejt pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me këtë gjetje të procedurës së verifikimit, si edhe dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij.

Kandidati ka paraqitur dokumentacionin përkatës i cili është përcjellë për kompetencë I.L.D.K.P.K.I-së nëpërmjet shkresës me nr. Prot. 2231 datë 06.10.2020.

33. Në përfundim të shpjegimeve të kandidatit, të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e shpjegimeve të kandidatit, të gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Sofia ZHILLA, I.L.D.K.P.K.I në raportin e paraqitur me nr. Prot. 140/27 datë 21.10.2020 ka ardhur në përfundimet se:

- a) **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;**

b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar të ardhurat e djalit në Sh.B.A;

c) ka mos deklaram të pasurisë;

ç) nuk ka kryer deklaram të rremë;

d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

34. Pra mbi bazën e verifikimeve të kryera nga organi përgjegjës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë arrin në përfundimin se hetimi i thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga I.L.D.K.P.K.I-së janë të plota dhe shteruese sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Sofia ZHILLA.

35. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Sofia ZHILLA nuk ka "kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij". Për rrjedhojë, për sa më sipër, ky kandidat gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

36. Konkretisht nga ana e Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, arrihet në përfundimin se I.L.D.K.P.K.I ka bërë një hetim të thelluar të pasurisë së kandidatit dhe burimeve të të ardhurave të tij në të gjitha institucionet shtetërore, bankat e subjektet e tjerë që gjenerojnë të dhëna për pasurinë e të ardhurat e subjektit dhe ka konstatuar sa më sipër.

37. Komiteti vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për Inspektor Jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

38. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatit Sofia ZHILLA është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimin të kushtit ligjor të përcaktuar nga neni 209, pika 6, ku përcaktohen "Kushtet për inspektor jo magjistrat", i ligjit nr. 115/2016.

39. Komiteti vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.

40. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jo magjistrat, Komiteti vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Sofia Zhilla në vendin vakant për Inspektor Jo magjistrat në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 27 e vijues të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Sofia ZHILLA, në vendin vakant për Inspektor Jo Magjistrat, , i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Sofia ZHILLA.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë , në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”, www.ild.al.

ANËTARE

Marsela PEPI

ANËTARE

Mirela KAPO

KRYETARI

Artur METANI

